# AKT THEMELIMI

## "Albanian Bees and Honey" sh.p.k.

Sot me date 18.10.2019, une i nenshkruari Z. Gjergj Legisi, i biri i Ndreut, datelindje 03.10.1986, lindur ne Tirane dhe banues ne Tirane, shpreh vullnetin per hartimin e ketij Akti Themelimi te Shoqerise "Albanian Bees and Honey" sh.p.k. si me poshte vijon:

## 1. FORMA LIGJORE

"Albanian Bees and Honey" sh.p.k., eshte nje shoqeri tregtare me pergjegjesi te kufizuar.

## 2. ORTAKET THEMELUES

Ortaku themelues i shoqerise me te gjitha kuotat eshte Z.Gjergj Legisi me 100 per qind te kuotave.

## 3. OBJEKTI

Objekti i veprimtarise se shoqerise "Albanian Bees and Honey" sh.p.k., eshte: prodhimi, paketimi dhe tregtimi i mjaltit;
prodhimi dhe tregtimi i zgjojeve, nenproduktet e tyre dhe lenden e pare; prodhimi, paketimi dhe tregtimi i qumeshtit te bletes; prodhimi, paketimi dhe tregtimi i nenprodukteve te bleteve dhe mjaltit importi dhe eksporti i produkteve te mesiperme;
importi dhe eksporti i pajisjeve, makinerive, automjeteve, produkteve, dhe nenprodukteve bujqesore e blegtorale;
transportimin e produkteve bujqesore dhe blegtorale;
qiradhenie dhe qiramarrje te pronave te paluajtshme, pajisjeve, makinerive dhe automjeteve;
ndertime gardhesh, muresh, deposh, magazina, konstruksione metalike, cati, shtresash betoni, shtyllash, hapje kanalesh dhe sisteme kullimi, si dhe punime te tjera ndertimore ne funksion te aktivitetit te biznesit;
tregtimin, perpunimin, prodhimin, transportin, importin dhe eksportin e te gjithe produkteve, pajisjeve dhe makinerive qe lidhen me aktivitetin e bleteve; tregtimin, rritjen, transportin, importin dhe eksportin e bimeve bujqesore e blegtorale, pemeve dhe luleve dekorative, pemeve frutore dhe perimeve;
cdo aktivitet tjeter qe i sherben direkt dhe indirekt permbushjes se objektit te shoqerise.

## 4. SELIA

Selia e shoqerise tregtare "Albanian Bees and Honey" sh.p.k., do te jete ne adresen: Ambient në Zonën Kadastrale Nr.2365, Pasuria Nr. 3/12, Volum 9, Faqe 188, Fshat-Lac, Sipas Çertifikatës së Z.V.R.P.P. Laç, Shqiperi.

Shoqeria ka te drejten te hape dege dhe te zhvilloje veprimtarine e saj ne te gjithe territorin e Republikes se Shqiperise.

5. KOHEZGJATJA

Shoqeria do te ushtroje aktivitetin e saj, sipas objektit, per nje periudhe te pacaktuar, e cila fillon nga data e regjistrimit te saj ne regjistrin tregtar.

6. KAPITALI I SHOQERISE

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 1.500.000 (nje milion e peseqind mije) Leke dhe mund te rritet ne baze te modaliteteve ligjore.

Kapitali perbehet nga kontribut ne natyre - pasuri e paluajtshme me vlere 1.175.000 leke dhe kontribut ne te holla - me vlere 325.000 leke.

Kapitali perbehet nga nje kuote e vetme e mbajtur nga ortaku i vetem.

7. ADMINISTRIMI

Shoqeria. do re administrohet nga administratori i vetem te cilit i jane dhene te gjitha kompetencat e drejtimit te zakonshem.

Administratori i vetem qendron ne detyre per nje mandat 5 - vjegar dhe per sa kohe nuk eshte revokuar nga ortaku i vetem si organi me i larte vendimmarres ne shoqeri.

Me kete akt, administrator i pare dhe i vetem i shoqerise emerohet Zj. Vojsava LEGISI.

8. VITET USHTRIMORE

Vitet ushtrimore mbyllen me 31 dhjetor te cdo viti. Viti i pare ushtrimor mbyllet me 31 dhjetor 2019.

Vendbanimi fiskal i crtakut te vetem do te jete selia e shoqerise per cdo efekt ligjor.

Ky akt themelimi eshte hartuar ne Tirane ne kater ekzemplare me vlere te njejte ligjore.

Shoqeria krijohet dhe do te ushtroje aktivitet ne perputhje me ligjet shqiptare ne fuqi, ligjit nr. 9901 date 14 04.2008 dhe ligje te tjera qe do te jene ne fuqi gjate periudhes se aktivitetit te shoqerise, si dhe ne perputhje me statutin qe konsiderohet pjese perberese e ketij akti dhe qe i bashkengjitet si ANEKSI B.

ORTAKU I VETEM

GJERGJ I LEGISi

